



Plani Komunitar për Trajtimin e Emergjencave në Komunitetin e Nishtullës



British Embassy
Tirana



FINNISH
GOVERNMENT



Plani Komunitar për Trajtimin e Emergjencave në komunitetin e Nishtullës u hartua në kuadër të projektit “Ndërtojmë së bashku përfshirjen, transparencën dhe fuqizimin pas tërmetit të vitit 2019” zbatuar nga Instituti i Kulturës Rome në Shqipëri – IRCA në partneritet me Qendrën Komunitare Multifunksionale Nishtullë, në kuadër të mbështetjes nga programi “Masat Reaguese të Mbrojtjes Sociale pas Tërmetit” (ESPR) , një projekt i zbatuar nga UNDP Albania dhe financuar nga Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar , Qeveria e Finlandës dhe Qeveria e Norvegjisë.

Ky dokument është përgjegjësi e autorëve dhe nuk reflekton domosdoshmerisht pikëpamjet e donatorit.

Plani Komunitar për Trajtimin e Emergjencave në Komunitetin e Nishtullës

Për çdo komunitet planifikimi përpara se të ndodhë një emergjencë, është më i lehtë sesa kur ndodh emergjenca. Nëse ndodh një emergjencë diku, policia, zjarrfikësit, kapiteneria detare, personeli i urgjencës dhe autorite të tjera lokale përgjigjen menjëherë. Ndërsa kur ndodh një situatë e rëndë apo emergjenca përshkallëzohet, këto entitete nuk mund të jenë kudo menjëherë (pasi do të duhet që t'ju japin përparësi njerëzve më në nevojë) ndaj duhet aktivizuar personel dhe burime shtesë.

Plani Komunitar për Trajtimin e Emergjencave për Nishtullën bazohet në ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe në ligjin 45/2019 “Për mbrojtjen civile”. Ai është produkt i një procesi hulumtimi, konsultimi dhe shtjellimi të ndërmarrë nga nëntori 2021 në shkurt 2022. Insituti i Kulturës Rome në Shqipëri (IRCA) dhe orientimet përkatëse, ndërsa konsulentja bashkëpunoi ngushtësisht me anëtarë nga komuniteti i zonës dhe një sërë entitetesh qeveritare dhe jo qeveritare përfshi Qendrën Komunitare Multifunkionale, QSH 7.2, Njësinë administrative 5, Bashkinë Durrës, Zjarrfikësen, Policinë, Qendrën Nehemia, organizatat USHTEN, Egjyptianët e Bashkuar të Shqipërisë dhe Kryqin e Kuq dega Durrës që ofruan gatishmërinë, njohuritë dhe dijet e tyre.

Plani Komunitar për Trajtimin e Emergjencave për Nishtullën, synon të mbështesë dhe përmirësojë reagimin për reduktim të rrezikut dhe të inkurajojë angazhimin komunitar në situata të menjëhershme ose të papritura duke siguruar mbrojtje civile. Plani është kritik për sigurinë dhe mbrojtjen e banorëve, të atyre që punojnë ose që e vizitojnë Nishtullën deri sa të vijnë reaguesit e emergjencave. Ky Plan Komunitar jep informacion për komunitetin në Nishtulla, priorizon emergjencat, evidenton grupet më vulnerabël, përcakton format e komunikimit, vendtakimin e sigurtë dhe kontaktet kyç të emergjencës, çfarë duhet bërë për të parandaluar emergjencat, ndihmuar dhe për rimëkëmbje. Por Plani nuk nënkupton kurrësesi që komuniteti duhet/mund të zëvendësojë autoritetet lokale ose shërbimet e emergjencave, apo që këto të fundit mund të reduktojnë përgjigjen ose shërbimin e tyre ndaj komunitetit të Nishtullës. Ky Plan është formuluar me një gjuhë të thjeshtë për të shmangur konfuzionin dhe është mjaft fleksibël për t'u përshtatur me çdo situatë. Ai sqaron menaxhimin e situatës dhe kontribuon në shmangien e krizave të tjera.

Trajtimi i emergjencave në territorin e Nishtullës nuk mund të jetë i pavarur nga planet emergjente të familjeve apo individëve, planet e entiteteve të tjera në këtë lokalitet¹, plani i zhvillimit, planet emergjente të komuniteteve fqinje, plani i emergjencave i Bashkisë Durrës dhe planet e bashkive fqinje, plani i emergjencave të Qarkut Durrës dhe i qarqeve fqinje, plani kombëtar i emergjencave.

Hartimi i Planit Komunitar për Trajtimin e Emergjencave në Nishtulla është një dokument i rëndësishëm që i dërgohet pushtetit lokal/shërbimeve të emergjencës. Nëse doni që komuniteti të veprojë në mënyrë adekuate në raste urgjente, duhet të realizoni paraprakisht trajnimin e individëve dhe të ekipeve. Ushtrimi në shkallë të gjerë i komunitetit ndihmon që të testohet Plani dhe të ruhet një nivel i lartë aftësie.

¹ Përfshirë por pa u kufizuar në qendra shëndetësore, qendra komunitare, shkolla, organizata, biznese etj.

TERMA KYÇ

Emergenca civile është situata e papritur me pasoja negative për komunitetin dhe që cënon sigurinë e tij, e cila shkaktohet nga fatkeqësitë që sjellin dëme të menjëhershme e të rënda për jetën e njerëzve, gjënë e gjallë, pronën, trashëgiminë kulturore dhe mjedisin.

Mbrojtje civile është tërësia e masave të marra për parashikimin, parandalimin, lehtësimin, gatishmërinë, përgjigjen dhe rimëkëmbjen nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera, me qëllim mbrojtjen e jetës së njerëzve, të gjësë së gjallë, të pronës, të trashëgimisë kulturore dhe të mjedisit.

Rezilienca është kapaciteti i komunitetit (përfshirë infrastrukturë, natyrë dhe ndërveprim social brenda tij) për të përballur një situatë të pafavorshme dhe për të arritur një gjendje të re dhe të shëndetshme ekuilibri (fizik, natyror, social, ekonomik dhe institucional) të ndryshëm nga ai para saj.

Plani Komunitar për Trajtimin e Emergjencave synon:

Të reduktojë rrezikun prej incidenteve dhe emergjencave në Nishtulla dhe në zonat pranë saj dhe të rrisë reziliencën përmes udhëzimit dhe angazhimit të shpejtë dhe efikas të komunitetit (para, gjatë dhe pas emergjencave) në bashkërendim me strukturat ekzistuese lokale të emergjencës.


Objektivat e Planit Komunitar për Trajtimin e Emergjencave janë:

- Të ndërgjegjësojë komunitetin e Nishtullës për rreziqet prej emergjencave (të shkaktuara prej natyrës, defekteve, gabimit njerëzor dhe shkatërrimit të qëllimshëm) si dhe për të parandaluar dhe minimizuar dëmet prej tyre.
- Të udhëzojë dhe të përgatisë komunitetin për veprimet që duhet të ndër-marrë deri sa të vijnë autoritetet e emergjencave, çfarë ju nevojiten si dhe për entitetet që mund t'u drejtohen për ndihmë në rast emergjencash.
- Të inkurajojë komunitetin që të përfshihet aktivisht dhe të mbështetë reaguesit për menaxhimin e krizave dhe rikuperimin prej emergjencave².

Përshkrimi i komunitetit në Nishtulla

Nishtulla ndodhet në lagjen 14 dhe ka një popullsi prej rreth 7.200 banorësh, të cilët janë të shpërndarë në mënyrë pothuaj të barabartë në të gjithë zonën. Banorët e zonës flasin shqip dhe kanë prejardhje të larmishme kulturore. Në Nishtulla ka të ardhur kryesisht nga Librazhdi, Kukësi, Tropoja, Hasi, Mirëdita, Përmeti dhe më pak nga zona të tjera. Rreth 330 familje të kësaj zone janë me përkatësi rome dhe egjiptiane. Sipas të dhënave të marra nga banorët një pjesë e familjeve të zonës kanë automjete.

Siç tregon edhe harta në vijim Nishtulla ka pozitë të favorshme gjeografike duke u shtrirë në rrugët kryesore automobilistike që të çojnë në, Tiranë, Shijak dhe në Sektor rinia. Relievi i zonës së Nishtullës është kryesisht fushor. Në Nishtulla ka një liqen i cili përdoret si pikë pushimi.



Pozicionimi në hartë i zonës së Nishtullës

² Institucionet dhe strukturat vendore të mbrojtjes civile janë Prefekti i qarkut, Komisioni i mbrojtjes civile në nivel qarku dhe bashkie, Bashkia, Strukturat e decentralizuara të institucioneve dhe të strukturave qendrore të mbrojtjes civile

Klima mesdhetare e Durrësit ndikohet nga faktori det (nëpërmjet të cilit bëhet i mundur qarkullimi i masave ajrore të Atlantikut dhe të Mesdheut.) dhe veprimtaria e njeriut, (nëpërmjet tharjes së kënetës, shpyllëzimit, ndërtimit të kanaleve ujëmbledhëse, ngritjes së banesave dhe objekteve industriale në toka bujqësore). Temperatura mesatare vjetore e ajrit në Durrës është 16°C, diellzimi numëron 2.026 orë në vit. Sasia mesatare e reshjeve është 963,4 mm/vit ose 116 ditë në vit. Vranësira, ka mesatare 4.7 ballë. Numri mesatar i ditëve të vranëta në Durrës është 89.9 ditë/vit ndërsa i ditëve të kthjellëta është 110.6 ditë në vit. Erërat karakteristike janë brizat. Gjatë verës ka rreth 71 ditë me briza, kurse në dimër 18 ditë. Numri mesatar vjetor është 191 ditë. Erërat që ndihen në Durrës janë murlani, shiroka dhe juga³.

Në Nishtulla operojnë këto shërbime shtetërore shkolla 9-vjeçare Isuf Ferra, Kopshti Isuf Ferra, Zyra Postare, Qendra Shëndetësore 7.2 dhe Qendra Komunitare Multifunktionale e Nishtullës. Shërbime të tjera që ofron qeveria vendore kanë të bëjnë kryesisht me mirëmbajtjen e rrugëve, mbledhjen e plehrave dhe ujërat e zeza. Përveç këtyre ka edhe kopshte, farmaci, klinika, mekanikë, lavazhe dhe shërbime të tjera private. Një xhami dhe kisha Nehemia shërbejnë për Zonën. Romët vulnerabël të zonës asistohen me shërbime nga Qendra Komunitare Multifunktionale, Qendra Nehemia dhe nga organizatat IRCA, USHT-EN dhe Egjiptianët e Bashkuar të Shqipërisë. Nishtulla ka grupe aktive komunitare të ngritura falë projekteve të ndryshme të cilat kontribuojnë për adresimin e nevojave dinamike të Komunitetit të Nishtullës.

Shqipëria ka legjislacioni të përshtatshëm për zhvillimin e ekonomisë së lirë të tregut. Në Nishtulla ekonomia bazohet në ofrimin e shërbimeve për komunitetin dhe zonat përreth. Aty përqendrohen disa aktivitete industriale, tregu i fruta perimeve, sera e luleve, sera e perimeve, tregu i veshmbathjeve dhe i makinave të përdorura. Çmimet janë tërësisht të liberalizuara, nuk ka kufizime në fushën e tregtisë dhe të lëvizjes së kapitaleve. Kjo zonë është pothuajse tërësisht e varur nga produktet e zonave përreth dhe nga eksporti. Disa familje të zonës kultivojnë fruta, perime, kafshë, shpendë dhe bletë kryesisht për konsum familjar.

Përshkrim i rezeqeve

Nishtulla është territor i ekspozuar ndaj fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera.

- Në dy shekujt e fundit tërmetet kanë qenë rrezik real në Durrës. Në 16-18 dhjetor të vitit 1926 Durrësi dhe rajonet rreth tij u goditën nga një seri tërmetesh me magnitudë që luhatej nga 5.8 në 6.2 që dëmtuan shumë ndërtesa. Midis Durrësit e Shijakut pati lëngëzim të truallit, shatërvanë uji të nxehtë e sulfur dhe pseudovullkane balte, rëre e ujë. Ky tërmet u shoqërua

³ Marrë nga <https://fv.al/t/pozita-gjeografike-e-rrethit-te-durresit.1565/>

nga shumë pasgoditje të cilat vazhduan edhe gjatë vitit 1927. Në 21 shtator të vitit 2019 Durrësi u godit nga një tërmet i fuqishëm me magnitudë 5.8 të shkallës rihter dhe me intensitet mbi 7,5 ballë. Ky tërmet nuk pati viktime por dhjetëra ndërtesa pësuan çarje, rrëzime të suvave si dhe dëmtime të pjesshme. Ndërsa në nëntor të vitit 2019 Durrësi u godit nga një tërmet me magnitudë 6.4 rihter që kishte epiqendrën në detin Adriatik. Ky tërmet dhe pasgoditjet shkaktuan humbje jete, plagosje dhe dëmtime të shumta në ndërtesa në Qarqet e Durrësit, Tiranës dhe Lezhës⁴. Sipas të dhënave të marra nga institucionet godinat e institucioneve u dëmtuan ndërta palestra e shkollës 9 vjeçare Isuf Ferra (e cila kishte pak vjet që ishte ndërtuar) doli jashtë funksionit. Sipas të dhënave të policisë dhe NJA 5, disa nga godinat më të dëmtuara të zonës së Nishtullës u rrëzuan përmes ndërhyrjes së forcave xheniere dhe u përfshirë në planin e rindërtimit. Pas këtij tërmeti u bë verifikimi në terren dhe mbështetja e të dëmtuarve. Falë mbështetjes nga shteti dhe donacionet QKM në Nishtulla, organizata USHTEN, qendra Nehemia dhe bizneset private mbështetën me grupet më në nevojë me kesh, ushqime dhe produkte higjieno-sanitare. Që nga korriku 2021 QKM e Nishtullës aktualisht po mbështet të prekurit nga tërmeti me shërbime përmes projektit ESPR të UNDP. Kopshti Isuf Ferra së fundmi është përfshirë në programin e rindërtimit EU4schools. Përgjithësisht ndërtesat në Nishtulla kanë mure dhe janë ndërtuar me cilësi mesatare. Ndaj këto ndërtesa në rast tërmeti mund të mos kenë shumë mundësi shkatërrimi ose shkaktimi vdekjesh.

Nga takimet me institucionet, konsultat me komunitetin dhe publikimet e mediave rezulton se Durrësi veçanërisht në dekadën fundit përveç tërmeteve, ka pasur përmbytje, stuhi, mot ekstrem, rrëshqitje toke dhe objektesh.

- Sipas të dhënave të mediave në mars, tetor dhe në nëntor të vitit 2016 Durrësi u përmyt nga reshjet e shiut. Vetë anëtarët e komunitetit në Nishtulla konfirmojnë se në vitin 2016 për shkak të reshjeve pa pushim kanali kullues i Nishtullës u fry dhe u bllokuan kanalizimet ekzistuese. Kjo shkaktoi përmbytje në zonën afër tregut dhe mbikalimit të Nishtullës. Sipas të dhënave të mediave në 30 janar 2015 qyteti i Durrësit dhe rrethinat u përfshinë nga një fortunal dhe erëra të forta momentale. Ky mot ekstrem goditi sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike, dëmtoi disa shtylla të ndriçimit rrugor të qytetit dhe shkuli disa pemë. Në dhjetor 2020 era e fortë që ka përfshirë gjirin e Durrësit, nuk kurseu as statujën e Redonit, e cila u vendos rreth në hyrje të shëtitorës “Taulantia” si simbol i fuqisë dhe përkatësisë pellazgo-ilire. Në muajt gusht 2017, gusht dhe shtator 2019 dhe në nëntor 2021 Durrësi u përfshi nga stuhi vetëtimash. Përmbytjet e mëdha në Nishtulla mund të mbulojnë rrugët, të bllokojnë ujërat e zeza, të ndotin furnizimin me ujë dhe të ndërpresin shërbimet e energjisë elektrike,

⁴ BASHKIA LEZHË Plani i Emergjencave Civile Dhjetor 2020

internetit apo telefonisë. Nuk mendohet se shumë banorë do të vdisnin nga përmbytjet gjatë qëndrimit në shtëpitë e tyre ose gjatë evakuimit, por është e mundur që disa të humbin jetën nëse përdorin rrugët e përmbytura.

- Sipas të dhënave të mediave në gusht 2019 moti ka qenë i nxehtë me temperatura deri në 40 gradë celsius. Fëmijëve, ashtu si të rriturve, dielli u sjell përfitime të rëndësishme për humorin, sistemin imunitar, kockat dhe lëkurën. Por ekspozimi i pakujdesshëm dhe i papërgjegjshëm mund të ketë pasoja negative të tilla si djegie nga dielli, dhe në një afat kohor më të gjatë fillimin e tumoreve, përfshirë melanomat. Simptoma të të nxehtit të tepërt janë ngërçet, edema, skuqja e lëkurës, goditja nga i nxehti dhe dehidratimi. I nxehti mund ta komplikojë situatën e pacientëve që vuajnë nga hipertensioni, nga problemet e zemrës dhe insuficienca renale, ose që përdorin ilaçe që përkeqësojnë efektet e goditjes së të nxehtit. Grupet më të rrezikuara nga i nxehti janë të moshuarit, fëmijët, foshnjat, të sëmurët kronikë, personat të cilët duhet të jenë të shoqëruar me kujdestarë dhe ata që kryejnë aktivitete fizike jashtë.
- Sipas mediave në 28 shkurt 2020 dhe fillim nëntori të vitit 2021 Durrësi u zbardh në pak minuta reshje breshëri me intensitet të lartë. Në dhjetorin e vitit 2019 një i pastrehë 38 vjeçar u gjend i vdekur në Durrës. Temperaturay e ulëta lidhen shpesh me gripin, ftohjen, goditjet në zemër dhe astmën, Gripi shkakton lodhje, dobësi, dhimbje koke, kollë dhe bllokime të hundës. Temperaturat e ulëta mund të zhvillojnë viruse të ndryshme që përhapen me shpejtësi në shkolla dhe zyra. I ftohti mund të shkaktojë infeksion në hundë, dhimbje të fytit, bllokim të hundës, teshtima, kollë, dhimbje koke dhe ethe. Në temperatura të ulëta, zemra e ka më të vështirë që të pompojë gjakun rreth trupit dhe kur një arterie koronare bllokohet, ndodh sulmi në zemër. Gjithashtu prej të ftohtit mund të shfaqen dhimbje të fytit. Frymëmarrja në ajër të ftohtë vështirësohet dhe rritet rreziku për një sulm astme.
- Sipas të dhënave të mediave në muajt shkurt dhe mars të vitit 2019 pati rrëshqitje dherash në Currila, që u pasuan me bllokim të rrugës nga balta, kurse në shkurt të vitit 2021 rrëshqitjet e tokës prekën zonën e varrezave të Durrësit. Anëtarë të komunitetit në Nishtulla mohojnë që në zonën e tyre ka patur rrëshqitje dheu por gjithsesi komuniteti është i rrezikuar. Nishtulla nuk ka pjerrësi të konsiderueshme, por rrëshqitjet mund të shkaktohen nga shirat e zgjatura, përmbytjet, ujërat nëntokësore që shpërndajnë depozitat e kripës etj. Dridhjet e tokës, ngarkesat artificiale të objekteve të krijuara nga njeriu si dhe presioni i ujërave nëntokësore mund të tërheqin grimca toke drejt udhëtimit. Rrëshqitjet e mëdha në Nishtulla mund të dëmtojnë rrugët, ndërtesat, të kanalizimet e ujërat e zeza, të ndotin furnizimin me ujë dhe të ndërpresin shërbimet e energjisë elektrike, internetit apo telefonisë, por nuk mendohet se shumë banorë do të humbasin jetën prej tyre.

Gjithashtu, Nishtullën e kërcënojnë edhe rreziqe të shkaktuara nga njeriu si sëmundjet, epideminë Covid, aksidentet, zjarret, plehrat, helmimet, grabitja, kërcënimi kibernetik, dhuna dhe trafikimi.

- Sëmundjet kronike janë shkaku kryesor i vdekjeve dhe i paaftësisë në botë. Sipas të dhënave të Qendrës shëndetësore 7.2 në Nishtulla duke filluar që nga muaji mars 2021 janë evidentuar, referuar dhe trajtuar 173 persona me sëmundje të ndryshme kronike. Krahas këtyre një pjesë e konsiderueshme e familjeve trajtohen nga Qendra shëndetësore 7.1. Disa prej faktorëve kryesorë të rrezikut për sëmundje kronike janë përdorimi i duhanit, konsumimi i alkoolit, përdorimi i pakët i frutave dhe perimeve, përdorimi i lartë i kripës në dietë, mos-aktiviteti fizik, shtypja e rritur e gjakut, obeziteti, rritja e glicemisë esëll, niveli i lartë i yndyrës në gjak etj. Nuk mendohet se shumë banorë të Nishtullës do të vdisnin nga këto sëmundje, por gjithsesi të sëmurët pengohen dhe kushtëzohen pasi iu çrregullohen funksionet trupore, kongnitive, sociale ose shpirtërore.
- Durrësi u prek për herë të parë nga shpërndarja e pandemisë COVID-19 në Mars 2020 dhe në kuadër të masave të ndërmarra për parandalimin e pandemisë u mbyllën aktivitetet ekonomike, aktivitetet social kulturore etj. Bazuar në të dhënat e QSH 7.2 që nga marsi 2021 në territorin e Nishtullës 74 persona u prekën nga virusi. Të dhënat nuk përfshijnë pacientët e QSH 7.2 dhe ata të ndjekur privatisht. Qeveria u angazhua në mënyrë aktive në ndërmarrjen dhe zbatimin e masave mbrojtëse dhe parandaluese për të kontrolluar shpërthimin e virusit COVID-19. Bashkia Durrës mori një sërë iniciativash të cilat ndihmuan komunitetin për përballimin e pandemisë dhe respektimin e protokollove për parandalimin e shpërndarjes së saj. U bë identifikimi i grupeve më në nevojë të cilët kishin vështirësi në përballimin e situatës si për shembull persona të moshuar, familjet që marrin ndihmë ekonomike, të papunët, familjet rome, familjet me persona me aftësi të kufizuara etj. me qëllim që të ofrohej mbështetja e nevojshme⁵ kryesisht nëpërmjet ndihmave ushqimore apo produkteve higjieno-sanitare. Falë vaksinimit ka pak gjasa që Covid-19 të jetë shkak i drejtpërdrejtë i shumë vdekjeve ose lëndimeve njerëzore, por gjithsesi prej tij mund të rriten kostot shëndetësore, të shkaktohen kufizime të lëvizjes dhe të udhëtimit, të merren masa të ruajtjes së distancës sociale, mund të ketë mbyllje të bizneseve dhe të shërbimeve, të realizohet në distancë ose të pezullohet procesi arsimor etj.
- Në 10 vitet e fundit për Nishtullën dhe zonën e Shkozetit jepet mjaft informacion për raste të ndryshme dhune. Sipas të dhënave të mediave në dhjetor të vitit 2013 u ekzekutua në klasë 16-vjeçari A.T. nxënësi i shkollës profesionale në Shkozet. Ekzekutimi i tij u bë në sy të shokëve dhe të mësuesit. Në mars 2020 në Nishtulla në rrugën afër tregut të perimeve u

⁵ Nga bashkia, rezervat e shtetit dhe donacionet

regjistrua një vrasje e dyfishtë. Viktima të ngjarjes së rëndë mbetën dy të rinj njëri nga të cilët kishte precedent të mëparshëm penal. Viktimat tek po lëviznin në këmbë, u qëlluan nga një automjet në lëvizje. Në prill 2020 në zonën të tregut të automjeteve në Nishtulla mbetën viktima të një atentati dy vëllezër. Ekzekutimi u bë kur vëllezërit ndodheshin në lëvizje e sipër brenda në makinë. Në dhjetor të vitit 2013 një person ka vrarë veten. Gjithashtu sipas të dhënave të mediave në korrik të vitit 2015 dy persona u arrestuan nga policia e Durrësit pasi u dyshuan si autorë të plagosjes së një shtetasi në një pikë servisi në Shkozë. Në janar 2016 mësuesi i shkollës 9-vjeçare “Hasan Koçi” në Shkozë, u shkarkua dhe u ndoq penalisht pas dhunës së ushtruar ndaj një nxënësi gjatë orës së mësimi. Në tetor 2019 policia ndërhyri për të parandaluar një konflikt mes disa personave në Shkozë por, dy prej pjesëtarëve në konflikt kundërshtuan me dhunë punonjësit e Policisë. Në 4 janar të vitit 2022 katër persona janë arrestuar në Durrës për dhunë në familje. Tre nga të arrestuarit ushtruan dhunë fizike dhe psikologjike ndaj grave, ndërsa i katërti rrahu motrën. Dhuna është një fenomen i cili dëmton mirëqenien fizike, emocionale, ekonomike dhe seksuale.

- Sipas të dhënave të mediave në qershor 2021 në Nishtulla të Durrësit, një automjet përplasi një këmbësor, i cili po kalonte në vijat e bardha. Automjeti ishte me shpejtësi tepër të lartë dhe nuk mundi të frenonte në kohë për të shmangur përplasjen. Ndërsa në nëntor të vitit 2021 një automjeti u përplas me trenin që kalonte në Shkozë. Në shkurt 2022 një 14 vjeçar vdiq në Durrës pasi e përplasi makina kur po mblidhte kanoçe. Në shkurt të vitit 2022 në lagjen Nr.14 një automjet me drejtues shtetasin Xh.M. përplasi një çiklomotor me drejtues shtetasin S. K., 15 vjeç. Njerëzit mund të plagosen dhe të humbin jetën prej aksidenteve. Nëse dikush është në një aksident, mund të rrezikojë zhvillimin e çrregullimeve të stresit post-traumatik.
- Sipas të dhënave të mediave në mars 2013 një zjarr i madh shkrumoi një magazinë me bimë mjekësore në zonën e Shkozëtit. Edhe pse zjarrfikëset shkuan shpejt në vendin e ngjarjes, nuk arritën ta izolojnë atë. Në orët e para të mëngjesit në shtator të vitit 2017 një zjarr përfshiu depot kryesore të ushtrisë në Shkozë të Durrësit duke shkaktuar dëme të mëdha. Në korrik të vitit 2018 një zjarr i fuqishëm ra në zonën e Shkozëtit në Durrës. Në 16 gusht 2021 një firmë për prodhimin e lëndëve ndërtuese i vendosën eksploziv (50 kilogramë tritol) 3 persona të maskuar. Fatmirësisht lënda plasëse nuk shpërtheu, ndërsa forcat xheniere realizuan çmontimin e saj. Nga një zjarr i fortë në Nishtulla mund të dëmtohet prona, të ndotet ajri, të kufizohen/devijohen lëvizjet, të ndërpriten shërbimet telefonike, interneti, energjia elektrike etj. Në disa raste, zjarret mund të shkaktajnë konflikte, trauma, dëmtim të shëndetit, por janë pak të mundshme vdekjet.
- Sipas mediave gjatë mesit të vitit 2021 Durrësi, dhe zona e Nishtullës u

ndeshën me problemin e mos heqjes së mbeturinave për disa ditë. Pas kësaj situata u përmirësua, sepse Bashkia Durrës mundësoi që mbeturinat të dërgohen në landfillin e Bushatit në Shkodër. Mbeturinat në Nishtulla mund të shkaktojnë dëme në shëndetin dhe në jetën e njerëzve nëpërmjet sëmundjeve. Era e mbeturinave dhe pamja ndikon në tokë, në ajër dhe në ujë. Sipas të dhënave të QKM në vitin 2016 Nishtulla, veçanërisht zona pranë barakave dhe zona e banesave rreth afër mbikalimit të Shënavlash-it patën problem me grumbullime të mbeturinave, por që u adresuan falë ndërhyrjes së Ndërmarrjes Komunale Plazh dhe UNDP. Kanali kullues i Nishtullës u pastrua në vitin 2019 dhe 2021, por ai ndotet vazhdimisht nga mbeturinat që vijnë nga zona e Kënetës si pasojë e reshjeve, derdhjes së kanalizimeve dhe mbeturinave⁶. Prej kripës dhe mungesës së kanalizimeve pusët në Nishtulla kanë ujë të ndotur. Pavarësisht kësaj dezinfektimi i zonave është kryer në mënyrë të vazhdueshme. Në vitin 2017 bashkia Durrës shtroi rrugën para qendrës shëndetësore të Nishtullës ndërsa në vitin 2018 u bë sistemimi i kanalizimeve tek vendbanimet rreth afër mbikalimit dhe tregut të fruta perimeve në Nishtulla përmes financimit të UNDP dhe mbështetjes së Bashkisë Durrës. Gjithë këto ndërhyrje kanë kontribuar sadopak në uljen e ndotjes.

- Sipas të dhënave të mediave në nëntor të vitit 2018 u helmuan 20 punonjëse të një fasonerie në Shkozë. Në janar të vitit 2019 gjashtëmbëdhjetë punonjëse të një fasonerie në qytetin e Durrësit u paraqitën në spitalin e Durrësit, duke shfaqur simptomat e helmimit. Dyshohet se shkak për këtë helmim masiv u bë rrjedhja e gazit të kondicionerit të ndërmarrjes. Edhe në janar të vitit 2020 u helmuan 20 punonjëse të një fasonerie në Shkozë. Shenjat kryesore të një helmimi janë të vjellat, heqja e barkut, temperatura, dobësia, zverdhja e lëkurës dhe djersitja. Helmimet mund të shkaktojnë humbje të aftësisë njohëse, zvogëlimin e hapësirës së përqëndrimit, ndryshim të sjelljes, disleksi, çrregullime të vëmendjes, hipertension, dëmtim të veshkave, imunotoksicitet, toksicitet në organet e riprodhimit etj.
- Grabitja mund të përfshijë pajisje e sende shtëpiake; mallra; objekte të vlefshme; sende me vlerë etj. Sipas të dhënave të mediave në prill të vitit 2013 një person ka hipur në taksì, me pretekstin se do të merrte gjyshen e sëmurë në shtëpi. Pasi ka shkuar në katin e dytë të apartamentit të tij në Shkozë, ai e lidhi, e grabiti dhe dhunoi taksistin. Pas kësaj i mbylli derën dhe u largua me gjithë makinën taksì. Më 5 maj 2013 shtetasi me iniciale M. K i ka vjedhur shtetasit E.V. 15 çadra dhe shezlongje, të cilat më pas i ka shitur për skrap në pikat e grumbullimit. Në nëntor 2018 ranë në pranga për vjedhje dy persona si dhe janë shpallur në kërkim dy të tjerë. Këta persona dyshohen se vodhën në tetor 2018 në lagjen Nr.14, Shkozë, Durrës dyqanet në pronësi të shtetasve T. K. dhe B.K. Në dhjetor të vitit 2018 një mjet tip 'Benz' me tre persona të maskuar dhe me armë kanë ndaluar makinën

⁶ Ndërtimet pa kriter me mungesë kanalizimesh dhe ndryshimet në rrjedhën e kanalit kullues sugjerojnë se përmbytjet mund të jenë më ekstreme në të ardhmen.

që transportonte paratë e një banke në Shkozet, e kanë grabitur dhe janë larguar në drejtim të Shijakut. Në tetor 2020 në Shkozet u vodh një makinë e cila ishte e parkuar autostradës. Dy persona hapën derën makinës nga ana e shoferit, e nderzën dhe më pas u larguan të ndjekur nga një makinë tjetër. Në prill të vitit 2021, gjatë natës tre persona morën nga kasaforta e një subjekti në Shkozet, mbi 1 milion lekë të reja. Në rast grabitjeje, mund të ketë dëmtim ekonomik dhe rrezikim të jetës ose shëndetit të viktimës.

- Nishtulla dhe Shkozeti janë një "korridor" trafiku droge dhe krimi. Sipas të dhënave të mediave në tetor të vitit 2018 dy persona ranë në prangat e policisë për trafikim të lëndëve narkotike. Dy të arrestuarit T.L. 29 vjeç dhe A. B. 22 vjeç ishin banues në Shkozet dhe kishin fshehur të paktën 2 kg kokainë brenda kroskotit të makinës. Në mars 2020 u bë arrestimi në flagrancë i shtetasit: A. Dh, 30 vjeç, banues në Nishtulla që merrej me shpërndarje të drogave të forta, kryesisht në fundjavë, në lokale nate. Gjithashtu, ky shtetas kishte siguruar një sasi farash kanabis sativa, dhe po përgatitej për ta kultivuar. Në prill të 2016 policia e Durrësit ndaloi shtetasin S. B. 29-vjeç banues në Shkozet i cili ishte shpallur në kërkim. Gjykata e Apelit Vlorë i kishte caktuar atij masën e sigurisë "Arrest me burg" për veprën penale "Trafikim të lëndëve narkotike". Trafikimi i drogave përfshin mbjelljen, përgatitjen, ruajtjen transportimin dhe shitjen. Grupet kriminale mund të targetojnë të rinj ose të mitur nga familje të varfra ose me probleme sociale, por jo vetëm. Nuk mund të flasim për një numër të saktë të përdoruesve të drogës në Nishtulla, por anëtarë të komunitetit pohojnë se pavarësisht punës së mirë të policisë vazhdon përdorimi i hashashit dhe të drogave të tjera kryesisht nga të rinjtë por edhe grup mosha të tjera. Drogat e jashtëligjshme mund të ndikojë tek ekonomia, shëndeti, puna, jeta personale, në familje dhe në rrethin shoqëror. Ato mund të turbulojnë humorin, nivelin e perceptimit, funksionin cerebral dhe potencialin e përdoruesit. Në periudhën afatshkurtër, përdoruesit të drogës mund ti rritet oreksi, ritmi i zemrës, aftësia e të menduarit, mprehtësia për perceptimin e tingujve dhe të ngjyrave. Drogat mund të shkaktojnë dridhje, ankth, agresivitet, qetësim, kënaqësi, ankth, paranojë etj. Në raste dozash shume të larta mund të ju humbë vetëdija, mund të vjellin, të kenë ulje të ritmit të rrahjeve të zemrës, tensionit, frymëmarrjes në nivelet e sigurisë duke i çuar drejt vdekjes. Drogat kanë një rrezik shumë të lartë të varësisë dhe në të tilla raste nuk mund të ndalohen për njëherësh sepse mund të shkaktojnë gjendje kome dhe vdekje. Trafikimi i drogave mund të shkaktojë sjellje agresive, sulme fizike, krime brenda familjes ose në komunitet, vjedhje, vetëvrasje etj.
- Entitetet dhe individët varen shumë nga teknologjia dhe interneti për të ndërvepruar, mbledhur apo përdorur informacione. Nëse sa më sipër nuk realizohet siç duhet mund të kthehet në kërcënim kibernetik duke shkaktuar parehati, shqetësim, zemërim, turpërim, humbje vetëbesimi, ndjenjë faji,

dëmtim ekonomik etj. Shkolla Isuf Ferra dhe QKM në Nishtulla pohojnë se kanë pasur raste kur përdorimi i teknologjisë dhe internetit ka sjellë me vete reagime prej prindërve, fëmijëve apo të tjerëve.

Secili prej kërcënimeve të sipërpërmendura është një problem në vetvete, por këto kërcënime mund të bëhen janë shkak i dëmtimit të tubave/pompave, bllokimeve të rrjetit të ujërave të zeza, dëmtimit të linjave të energjisë elektrike, ndërprerjeve/luhatjeve të energjisë, vështirësimit të furnizimit, mungesës së ushqimit/ujit, ndotjes së ajrit/mjedisit, dëmtimit të kulturave të mbjella, kufizimit/devijimit të lëvizjeve, ndërprerjes së komunikimit telefonik ose përmes internetit, mos pasjes së ilaçeve dhe lëndëve djegëse, ndërprerjes së procesit mësimor/mësimdhënies online, ndërprerjes së transportit, mos aksesimit në shërbim shëndetësor bazë dhe në shërbimet e tjera. Në disa raste, situatat e pa favorshme mund të shkaktojnë edhe konflikte, trauma, dëmtim të shëndetit, mungesë higjienë, dëmtim prone/infrastruktura, humbje jete etj.

Grupet më vulnerabël në Nishtulla

Emergjenca dhe fatkeqësi të mëdha kanë ndodhur gjatë historisë, por me rritjen e popullsisë burimet bëhen më të kufizuara dhe komuniteti është gjithnjë e më vulnerabël ndaj rreziqeve që shkaktojnë fatkeqësi.

Grupet më vulnerabël ose potencialisht më të rrezikuara të zonës të Nishtullës kanë nevoja shtesë para, gjatë dhe pas një emergjence apo incidenti. Bazuar në vlerësimin e bërë nga komuniteti dhe përfaqësues të entiteteve lokale në Nishtulla konsiderohen si grupe më vulnerabël fëmijët, femrat, personat me aftësi të kufizuara, të moshuarit, romët, migrantët dhe emigrantët, të varfrit dhe punëtorët jo formalë.

Gjatë emergjencave **fëmijët** rrezikojnë trauma, rraskapitje, lëndime, dehidrime dhe kequshqyerje. Fëmijët kanë më shumë gjasa se të tjerët që të preken prej infeksioneve dhe sëmundjeve. Ata mund të dëmtohen nga ekspozimi ndaj agjentëve të bioterrorizmit për shkak të metabolizmit, ritmeve të frymëmarrjes dhe të faktorëve të tjerë. Trajtimi që është adekuat për të rriturit mund të jetë i pakujdesshëm nëse u jepet pacientëve pediatrikë, pasi ka dallime fiziologjike mes fëmijëve dhe të rriturve. Në emergjenca pacientët pediatrikë kanë nevojë për lloje/doza të ndryshme ilaçesh, për shtretër dhe pajisje mjekësore me madhësi të ndryshme nga të rriturit. Gjithashtu kujdesi për ta është sfidues, pasi kanë kufizim në aspektin konjitiv dhe kanë varësi nga të tjerët (për jetesë, në aspektin emocional dhe në vendime).

Femrat përgjithësisht përkujdesen për të tjerët, ndaj në rast emergjence ato mund të rrezikojnë dëmtimin fizik, psikologjik, të humbasin rrjetet mbështetëse

ose jetën. Femrat mund të evakohen pa akses në materiale higjienë dhe dokumente mjekësore që përmbajnë informacione kritike për mirëqenien e tyre ose të foshnjës. Disa gra shtatzëna gjatë emergjencave dhe fatkeqësive mund të lindin pa kujdes spitalor. Shtatzënat mund të rrezikojnë lindje të parakohshme, vdekshmëri foshnjore dhe foshnja nën peshë. Ato mund të humbasin aksesin në vitamina prenatale ose në mjekime të tjera thelbësore. Në vendstrehime me dyndje njerëzish gratë dhe fëmijët e tyre janë të ekspozuar ndaj infeksioneve dhe viruseve. Gjithashtu gratë mund të përfshihen në vaksinimin masiv ose në programe profilaktike të kundërrindikuara për shtatzaninë ose sëmundje të caktuara. Pas një fatkeqësie femrat kanë më shumë gjasa të braktisin arsimin apo të humbasin punën. Ato mund të kenë dhunë në familje, punë të pasigurt dhe të ardhura të kufizuara. Femrat mund të mos kenë informacion, akses në burime dhe përfshirje në vendimmarrje.

Në fatkeqësitë në shkallë të gjerë **personat me aftësi të kufizuara fizike** dhe mendore mund të jenë të pafuqishëm dhe të sfiduar. Për individët me paaftësi fizike mund të mos shërbehet në mënyra të ndryshme, ndihma mund të jetë e pamjaftueshme dhe mund të ndërpritet shumë shpejt. Disa ofrues të shërbimesh mund ti trajtojnë personat me aftësi të kufizuara me prioritet më të ulët se të tjerët, sepse trajtimi i tyre është më i vështirë ose e komplikuar. Personat me dëmtime të dëgjimit mund të mos jenë në gjendje kuptojnë urdhrat e evakuimit ose udhëzimet e dhëna në vendstrehim. Nëse komunikimi zyrtar transmetohet vizualisht në televizor ose në letër, njerëzit me dëmtime shikimi mund të mos jenë në gjendje të marrin informacione kritike. Gjatë emergjencave transporti mund të mos jetë i disponueshëm për të evakuar personat në karroca me rrota. Në vendstrehime këta persona mund të mos kenë akses në hyrje, tualete, mensë ose aty ku jepet kujdesi i përshtatshëm mjekësor. Në zonat që janë shkatërruar nga një fatkeqësi ata mund ta kenë më të vështirë sigurimin e apartamenteve ose aksesimin në kontejnerë, kujdes shëndetësor, shkollim dhe punësim. Në rast emergjence evakuimi i individëve me aftësi të kufizuara mendore mund të keq menaxhohet nga reaguesit e urgjencave që keqkuptojnë sjelljen e tyre ose nuk ndjehen rehat me ta. Këta mund të institucionalizohen në mënyrë të papërshtatshme ose të përfundojnë në vend strehime mund tu refuzohet strehimi, ku mund të mos plotësojnë dot nevojat e tyre ose mund të trajtohen me ashpërsi nëse nuk ndjekin udhëzimet. Individët me aftësi të kufizuara mendore mund të mos jenë të aftë të jetojnë të pavarur, të aplikojnë për strehim, rindërtim ose mund të mos marrin ndihmë për këtë.

Personat e moshuar kanë më shumë gjasa se të tjerët që të vuajnë nga një ose më shumë sëmundje kronike si artriti, hipertensioni, sëmundje të zemrës, diabeti dhe sëmundje të frymëmarrjes. Të moshuarit gjithashtu mund të vuajnë prej kufizimeve në lëvizshmëri, njohëse, shqisore, sociale dhe ekonomike. Sa më sipër mund të pengojë përshtatshmërinë dhe aftësinë e tyre për të funksio-

nuar në rast fatkeqësish. Gjatë dhe pas emergjencave shëndeti i të moshuarve mund të përkeqësohet për shkak të keq ushqyerjes, temperaturave ekstreme, ekspozimit ndaj infeksioneve, ndërprerjes së trajtimit mjekësor, stresit dhe traumave. Nëse të moshuarit kanë edhe aftësi të kufizuara, ata mund të kenë nevojë për përkujdes dhe mbështetje të veçantë.

Romët në Nishtulla jetojnë ngjitur me zona të cënueshme ndaj përmbytjeve dhe që kanë problematika mbeturinash. Ata përgjithësisht përfshihen në punë informale/sezonale dhe përpiqen thjesht për të siguruar strehimin dhe ushqimin. Romët kanë më shumë gjasa të mos kenë as burime për të menaxhuar emergjencat e vogla financiare, as mjetet mbrojtëse të përshtatshme as të mund të evakujnë të sigurt. Romëve mund ti mungojë arsimimi, aksesit në informacion, pajisjet elektronike, interneti si dhe aftësitë. Përgjithësisht Romët në Nishtulla pas tërmetit të 2019 nuk përfituan dot nga mbështetja në ushqim, tenda dhe në materiale të tjera emergjence, pasi sipas tyre ndihma u përqendrua në zonën e stadiumit Niko Dovana dhe të Pallatit të Sportit Ramazan Njala. Gjatë mbylljes prej Covid-19 mungesa e sigurimeve shoqërore i pengoi ata për marrje page lufte. Gjithashtu Romët përgjithësisht nuk aplikojnë për ndihmë ekonomike dhe kishin shtëpi pa dokumenta/legalizim, ndaj kishin më pak gjasa që të përfitonin siguracionin e kompanive dhe ndihmat e tjera pas fatkeqësisë. Ata mund të kenë më shumë gjasa që pas emergjencës të braktisin arsimin ose të përfshihen në punë informale dhe të rrezikshme.

Në Nishtulla jetojnë imigrantë nga rrethet e tjera të vendit dhe emigrantë nga vende si Egjipti, Siria, italiane etj. Të huajt mund të kenë barriera gjuhësore që në rast emergjence i pengojnë që të ndjekin komandat dhe udhëzimet e autoriteteve të emergjencave. Në emergjencën e sigurimit i përkthimit për ta, mund të jetë i vështirë ose jo i duhur. Komuniteti jo gjithmonë mund të mirëpresë migrantët dhe emigrantët dhe në rast emergjence ata mund të mos kenë ku të shkojnë. Personat pa pashaportizim në Durrës dhe emigrantët pa dokumente mund të kenë nevojë, por mund t'ju mungojnë njohuritë se c duhet të bëjnë ose mund të hezitojnë që të kërkojnë ndihmë tek autoritetet. Pavarësisht se në kuadër të emergjencës autoritetet mund të ofrojnë ndihmë afatshkurtër, nëse personat kanë status të paligjshëm mund të mos përfitojnë dot strehim, ushqime, leje për dalje etj. Meqenëse këta kanë më pak gjasa që të zotërojnë shtëpi, s'përfitojnë dot nga të ardhurat e siguracionit dhe ndihmat e tjera pas fatkeqësisë.

Nga të ardhurat e ulëta të **varfrit**, mund të detyrohen të jetojnë në banesa pa lehtësira dhe me infrastrukturë të përshtatshme. Ato mund të mos disponojnë automjete për t'u evakuuar, për të lëvizur, mund të mos plotësojnë dot nevojat bazale apo mund të mos sigurojnë dot mjete mbrojtëse të përshtatshme. Të varfërve mund t'ju mungojë aksesit në informacion, pajisje elektronike, internet

si dhe aftësitë për ti përdorur ato. Rrjedhimisht ata mund të braktisin më shpejt shkollën ose mund të humbasin vendin e punës. Këto grupe të pafavorizuara gjatë emergjencës mund ti humbasin gjërat nga të cilat varet mbijetesa e tyre. Mungesa e sigurimit shoqëror dhe mjekësor mund t'i pengojë ata për marrje paze lufte dhe për trajtim mjekësor të përshtatshëm. Përveç kësaj, të varfrit kanë më pak gjasa që të zotërojnë banesën dhe të përfitojnë nga të ardhurat e siguracionit dhe ndihmat e tjera pas një fatkeqësie. Ata kanë më shumë gjasa që pas emergjencës të përfshihen në punë informale, të rrezikshme, pa marrë trajnimet dhe pa patur mjetet mbrojtëse të duhura. Nëse këto situata emergjence janë të përsëritura ata mund të mos përballojnë, përshtaten ose ta marrin dot veten.

Veprime kyç në komunitet para emergjencave:

- Informohuni përditë për motin dhe gjëra të tjera, të cilat mund të rrezikojnë komunitetin tuaj.
- Mësoni se çfarë duhet bërë në lloje specifike emergjencash përmes fletëpalosjeve, kërkimit në internet, forumit të emergjencave etj.
- Shkarkoni në telefonin tuaj celular aplikacione informimi në kohë reale për motin, bllokimet e rrugëve, gjetjen e vendndodhjes, tërmetet, etj. (p.sh Akum weather për motin, Google Maps për orientimin në udhëtim, CSEM për tërmetet, etj.)
- Hartoni një Plan Familjar emergjencash sipas aneksit 1 (në aq kopje sa anëtarë ka familja juaj)
- Bëjeni Planin Familjar të emergjencave aq kopje sa anëtarë ka familja juaj. Mbajeni çdo herë me vete (p.sh. në çantë, portofol, makinë etj.) dhe në një vend lehtësisht të gjetshëm (p.sh. një tek çanta/kutia e emergjencës).
- Ushtroni për ta testuar dhe përditësojeni planin familjar të emergjencave të paktën çdo 6 muaj.
- Hiqni ca para mënjanë (p.sh në një llogari apo vend të sigurt) për çdo rast emergjence në familjen tuaj.
- Krijoni një ose më shumë çanta/kuti emergjence të mjaftueshme për 3 ditë për familjen tuaj (për njerëzit dhe kafshët shtëpiake) me ujë/ushqim, mjete të ndihmës së parë, dokumente kyç, materiale higjieni, elektrik dore, veshje, bateri etj
- Zëvendësoni periodikisht në çantë/kuti të emergjencës gjërat që prishen apo skadojnë.

- Krijoni dhe publikoni si komunitet një regjistër për emergjencat që ju prekin.
- Krijoni një forum lokal komuniteti p.sh. me informacion si duhet vepruar në emergjencë, për plotësim pyetësorësh mbi sigurinë, për të informuar për ushtrim/testim të planit komunitar me grupe multidisiplinare ose mundësi trajnimi për emergjencat.
- Krijojini akses komunitetit në Planin Komunitar për Trajtimin e Emergjencave përmes formateve të printuara⁷, fletë volantit⁸, faqes web etj.
- Bisedoni me fqinjët, bizneset, entitetet etj. për Planin Familjar/Komunitar të Emergjencave dhe se si mund ta mbështetni njëri-tjetri.
- Zhvilloni paraprakisht procedura për mbyllje emergjente të shërbimeve në komunitet.
- Realizoni çdo vit trajnime ndihmën e parë, mbrojtjen, shpëtimin, evakuimin, karantinimin, komunikimi për emergjencat etj. me popullatën e zonës së Nishtullës, organizatat dhe stafin e autoriteteve publike/private.
- Ushtroni për Planin Komunitar të Trajtimit të Emergjencave me koordinim të shumë-agjencive për të shmangur komplikimet në rast emergjence dhe bërë modifikimet aty ku nevojitet.
- Rishikoni Planin Komunitar të Trajtimit të Emergjencave dhe kontaktet kyç përkatëse.
- Identifikoni paraprakisht persona nga komuniteti që mund të kenë nevojë për ndihmë (probleme psikike, aftësi e kufizuar, probleme sociale etj.) mënyrat për t'i kontaktuar ata në rast emergjence, udhëzimet për evakuimin e tyre në emergjencë, kontaktet e miqve apo familjarëve që mund t'ju ofrojnë mbështetje.
- Kërkoni dezinfektim profesional periodik dhe sipas dinamikave të rasteve.
- Mos hidhni mbeturina dhe mos mbyllni puseta, kanale etj.
- Mos dëmtoni prita dhe diga mbrojtëse.
- Mos pritni pemët sepse ato e mbrojnë tokën nga gërryerja.
- Kërkoni instalim paraprak valvulash kontrolli për të parandaluar që uji i përmbytjes të kthehet në kanalizimet e godinës.
- Siguroni godinat/banesat/mjetet etj. dhe kuptoni se çfarë ju mbulon siguruesi.
- Kujdesuni dhe mirëmbani periodikisht ndërtesat, automjetet, prizat, akse-

⁷ Pa të dhëna personale kontakti

⁸ Aneksi 2

sorët e gazit, rrjetin elektrik, fikëset e zjarrit, sinjalizuesit e tymit dhe të gazit etj.

- Mësoni ku është dhe si fiket automati, mbyllet uji, bllokohet rrjedhja e gazit etj.
- Siguroni plane të sakta të instalimeve dhe tubacioneve të banesës ose ndërtesës.
- Shmangni vënien njëherësh në punë të disa pajisjeve elektrike, pasi shkakton ngarkesë në rrjet.
- Siguroni lidhje energjike që të shërbejnë si burim rezervë në rast emergjence.
- Instaloni tuba, pajisje fleksibël dhe tela cilësorë për shmangjen e rrjedhjeve të gazit, karburantit/ujit apo të masës.
- Siguroni ndriçim emergjent, gjeneratorë dhe stabilizatorë tensioni.
- Fiksoni në mur mobiljet ose pajisjet/pajisjet që mund të bien dhe të shkaktojnë lëndime.
- Vendosni poshtë sendet e mëdha dhe/ose të rënda.
- Inspektoni periodikisht ndërtesat për siguri dhe kontrollojini për dëmtime.
- Mbani automjetet në pronësinë tuaj apo të entiteteve/bizneseve me anti-frizë dhe karburant të mjaftueshëm.
- Mbani kredit të mjaftueshëm në telefon ose një kartë telefoni me parapagesë për çdo rast emergjence.
- Mbani baterinë e telefonit të karikuar dhe përpiquni që të siguroni fisha karkimi që mund ti përdorni në automjet.
- Siguroni pajisje jo elektrike komunikimi (psh. orë smart, radio me bateri, televizor për automjet etj.) për të komunikuar me të tjerët apo për tu informuar në rast emergjencash.
- Ruani në telefonin tuaj celular numra kyç të emergjencës ose mund të vendosni pranë telefonit fikse listën përkatëse të numrave.
- Mësoni dhe praktikohuni paraprakisht për mesazhe, përdorim whatsappi apo të ndonjë aplikacioni tjetër, që të mund të komunikoni me të tjerët edhe nëse linjat telefonike janë jofunksionale ose të mbingarkuara.
- Kontaktoni kompaninë telefonike përkatëse dhe mësoni paraprakisht si të

bëni transferimin e thirrjeve nga telefoni fiks në atë celular.

- Zgjidhni një numër kontakti për emergjencë (të një miku apo të afërmit tuaj) dhe informojeni atë paraprakisht, për nevojat shëndetësore apo nevojat e tjera që ju keni.
- Forconi sigurinë kibernetike përmes përdorimit të passwordeve të forta, update të pajisjeve, backup të të dhënave etj.
- Identifikoni paraprakisht entitete që mund të mbështesin Nishtullën. Tregoni gatishmëri për ti ndihmuar në përditshmëri dhe kërkoni ndihmën e tyre në rast emergjence.
- Ndhmoni të tjerët që të mund të përgatiten sadopak për emergjencat.
- Orientoni anëtarë aktiv të komunitetit se si mund të shkruajnë kërkesa ndaj entiteteve dhe të advokojnë për zgjidhjen e problematikave.
- Identifikoni paraprakisht vullnetarë nga komuniteti, merrni kontaktet e tyre dhe saktësoni llojet e mbështetjes që ata mund të ofrojnë në rast emergjence (psh, informacion, pije/ushqim, veshje, ngohje, strehim, ndihmë në dokumentim, ndihmë në shpërndarje paketash, njoftim derë më derë) etj.
- Advokoni që në emergjencë të zhvillohen sisteme transporti të larmishme dhe që i rezistojnë kushteve ekstreme.

Grupi Komunitar i Emergjencave

Grupi Komunitar i Emergjencave në Nishtulla është një grup i trajnuar vullnetarësh për të vepruar para se të ndodhë emergjencë, për të dhënë ndihmë bazë për komunitetin në rast emergjence dhe për të ndihmuar rimëkëmbjen pas emergjencës. Ky Grup përbëhet nga 5 veta: koordinatori vullnetar për emergjencat dhe 4 anëtarë (1 për secilën zonë)⁹ që duhet të reflektojnë diversitetin gjinor dhe atë komunitar.

Aktivizimi i Plani Komunitar për Trajtimin e Emergjencave

Nëse merret paralajmërim për një ngjarjeje, ndodh një emergjencë, shërbimet e emergjencës nuk janë në gjendje të vijnë menjëherë ose shërbimet kanë nevojë për mbështetje Grupi Komunitar i Emergjencave në Nishtulla takohet që të vlerësojë situatën duke ndjekur formatin në Aneksin 3.

Në vijim, nëse nevojitet Grupi Komunitar për trajtimin e Emergjencave në Nishtulla kontakton me agjencitë reaguese të emergjencave ose konsultohet me strukturat lokale të emergjencave në Durrës. Në konsultim me ta Grupi Komunitar e aktivizon Planin Komunitar të Trajtitimit të Emergjencave sipas nevojës

⁹ Nishtulla është ndarë për lehtësi në 4 zona dhe secila përcakton një anëtar për emergjencë

pjesërisht ose të plotë.

Veprimet e ndërmarra para, gjatë dhe pas emergjencës mbahen shënim dhe ndihmojnë për vlerësimin nëse është e nevojshme apo jo që të ndryshohet Plani Komunitar për Trajtimin e Emergjencave.

Veprimet kyç në rast emergjence

Pavarësisht se cila është emergjenca (tërmete, përmytje, stuhi, mot ekstrem, rrëshqitje toke, rënie objekti, sëmundje, epidemi, dhunë, aksidente, zjarr, plehura, helmim, grabitje, kërcënim kibernetik, rrëmbim, trafikim etj.) në varësi të dinamikës:

- Ndizni alarmin më të afërt.
- Mbushni vaska, legenë, kova etj., me ujë të pastër për ti përdorur në rast se uji do të ndërpritet ose do të ndotet.
- Karikoni pajisjet elektronike ose mbani bateri rezervë për
- Ndërprisni energjinë elektrike, gazin dhe ujin aty ku kushtet e lejojnë.
- Merrni masa që të mbron çfarë dispononi dhe të reduktoni dëmet.
- Mbron dhe merrni me vete informacionet dhe të dhënat e rëndësishme.
- Kryeni një hetim fillestar për t'u siguruar që mjedisi nuk ka rrezik. Nëse mjedisi ka rrezik, vlerësoni nëse mund të bëhet më i sigurt dhe pastaj ndërhyeni.
- Zvarrituni poshtë nëse rruga e daljes është e bllokuar prej tymit.
- Ofroni për të dëmtuarit (sipas nevojës) ndihmën e parë.
- Nëse largoheni nga godina merrni me vete kutinë e emergjencës dhe qëndroni së bashku.
- Kontrolloni mirë rrugën para se ta kapërceni. Qëndroni në heshtje dhe mos vraponi në mënyrë që urdhrat e dhënë të kuptohen qartë nga të gjithë.
- Nëse është e sigurt, kontrolloni fqinjët dhe njerëzit e pambrojtur që jetojnë pranë jush dhe i ndihmoni që të largohen nga zona e pasigurt.
- Përdorni rrugë të përcaktuara ose rrugë alternative për evakuim.
- Kontaktoni me autoritetet reaguese të emergjencave (si: urgjenca, policia, zjarrfikësja etj.) nëse nevojitet ndihmë e mëtejshme dhe ndiqni udhëzimet

e tyre.

- Bëni vetëm telefonata të shkurtra për tu transmetuar informacione jetike personelit të urgjencës dhe/ose familjes, pasi në të kundërt mund të ngarkoni linjën dhe të pengoni ata që kanë më shume nevojë për ndihmë.
- Përdorni mesazhet (me tekst, e-mail ose media sociale) për komunikime jo urgjente.
- Nëse nuk arrini të kryeni një telefonatë urgjente duke përdorur celularin tuaj, prisni dhjetë sekonda përpara se të riformuloni për të ndihmuar në uljen sadopak të mbingarkesës së rrjetit.
- Realizoni takimin fillestar të Grupit Komunitar për Emergjencat në Nishtulla.
- Aktivizoni Planin Komunitar të Emergjencës (të plotë ose të pjesshëm).
- Mos i lëvizni personat e dëmtuar shumë, pasi mund të përkeqësohen.
- Zhvendoseni një të dëmtuar, vetëm po qe se situata është e pasigurt.
- Mbroni veten nga kontakti me fluidet trupore të të dëmtuarve.
- Shkoni në vendtakimin e sigurt të emergjencave në komunitet (nëse nuk keni detyra specifike) dhe qëndroni në gatishmëri.
- Lehtësoni strehimin dhe evakuimin e të prekurve nga emergjenca.
- Shfaqni përkujdesje dhe inkurajoni personat që të shprehin ndjenjat e frikës, ankthit ose nervozizmit.
- Mbroni dhe ruani privatësinë e personave.
- Angazhoni persona kyç nga komuniteti për të lehtësuar punën në komunitet,
- Mblidhni informacion/të dhëna duke i përfshirë të të gjithë grupet (bura, gra, fëmijë etj);
- Evidentoni nevojat e grupeve të ndryshme (moshore, gjinore, të aftësive, etnike etj);
- Nëse vullnetarizoni respektoni dëshirat e të prekurve nga emergjenca, mos e vini veten në rrezik dhe mos pengoni reagimin e organizuar të agjencive të emergjencës.
- Mediat i mbani larg, por i lejoni të bëjnë punën e tyre. Kërkesat e medias ia referoni zëdhënësit zyrtar.

Kujdes!

- Para nisjes kontrolloni rrugën dhe automjetin.
- Kurseni baterinë e celularit tuaj duke ulur ndriçimin e ekranit, duke e vendosur telefonin në modalitetin flight mode dhe duke i mbyllur aplikacionet që nuk po i përdorni.
- Përdorni radion e makinës tuaj ose atë me bateri për të marrë lajme të rëndësishme nga mediat.
- Mos hyni/dilni nga ndërtesa deri sa autoritetet të përcaktojnë nëse kjo gjë është e sigurt.
- Përdorni gjatë udhëtimit rripin e sigurimit për të rriturit dhe sexholinot për fëmijët.
- Ndaloni automjetin larg zonave të rrezikut (banesave, mureve që mund të shemben, pemëve, tabelave, mjeteve, shtyllave elektrike, grumbullimeve të njerëzve etj.)
- Mos provoni të ecni përmes vërshimeve të ujit apo në urën e një lumi të fryrë.
- Mos ngitni automjetin në rrugë të përmytura sepse makina mund të bllokohet.
- Shmangni qëndrimin tuaj vetëm në një makinë të parkuar apo me xhama të mbyllur.
- Evakuoni personat jashtë në rast dëmtimi të automjetit. Nëse është e nevojshme njoftoni policinë dhe zjarrfikësen.
- Bëni transferimin e thirrjeve nga telefoni fiks në atë celular në rast evakuimi.
- Ndaloni në anë të rrugës përpara se të bëni telefonatën, nëse në makinën tuaj nuk keni një pajisje për ta mbajtur telefonin pa dorë.
- Shkruani mesazhe në celular, vetëm pasi keni ndaluar automjetin.
- Shmangni pirjen e ujit direkt nga çezma pasi ai mund të jetë i ndotur.

Komunikimi dhe kontaktet në emergjenca

Në emergjenca nëse komunikimi i zakonshëm shpëputet mënyra alternative përmes të cilave mund të ruani kontaktin është:

- Qëndrimi pranë njëri-tjetrit

- Pema e komunikimit me celular/whatsapp (një kontakton disa, dhe këta të fundit disa të tjerë)
- Televizioni/interneti/mediat sociale
- Pajisjet jo elektronike të komunikimit
- Trokitja derë më derë

Nëse duhet që të telefononi shërbimet e emergjencave përmbajuni formatit më poshtë:

Jam _____ dhe po ju marr nga Nishtulla. Ka ndodhur një incident në _____ që kërkon ndërhyrje nga _____. Ka _____ të dëmtuar në kushte _____ dhe _____ viktime. Ju lutem e jani duke përdorur rrugën _____. Një person po ju pret në hyrje.

Mbylleni telefonatën vetëm nëse Operatori i emergjencës ju konfirmon se i ka mbajtur shënim të dhënat e nevojshme.

Në tabelën në vijim janë listuar disa numra kontakti që mund ti përdorni në rast nevojë.

Pozicioni/personi	Kontakt
Grupi Komunitar për Emergjencat në Nishtulla	
Koordinatori komunitar për menaxhimin e emergjencës	
Anëtar 1	
Anëtar 2	
Anëtar 3	
Anëtar 4	
Shërbimet e emergjencave	
Emergjenca	112
Zjarrfikësit	128
Urgjenca mjekësore	127
Policia	129
Policia rrugore	126
I plotfuqishmi i zonës - Qani Xhixha	069 61 51 142

UKD - Fatmir Karaj	069 85 95 560
OSHE	052 902 222
Qendra shëndetësore - Evis Como	068 61 92 568
Kryqi i kuq Durrës - Kreshnik Cerma	069 22 68 431
NJVKSH - Dhurata Troplini	069 22 98 735
Prefekti i qarkut - Emiljan Jani	068 21 33 479
Bashkia stafi i emergjencave - Andri Cerri	068 52 00 696
Shefi i Shtabit të Emergjencave Civile të Prefekturës Durrës - Artur Lekbello	069 41 17 308
Autoritetet lokale	
Kryetari i i NJA 5 - Erion Meka	069 76 38 219
Njësia për mbrojtjen e fëmijës - Arlind Vata	069 33 55 289
Koordinatori për dhunën në familje - Adiola Mullaj	069 74 71 886
Qendra për fëmijët me aftësi të Kufizuar - Alda Agolli	68 416 5130
Qendra e emergjencave - Viola Cikalleshi	069 36 51 315
Qendra Ditore e të Moshuarve - Megi Hasani	069 84 97 767
Qendra Komunitare Multifunkionale - Bledina Bushi	0697094072
Linja telefonike e gjelbër	116 111
Entitete të tjera	
Save the children - Edlira Ngjeci	069 583 3017
IRCA – Bledar Taho	069 618 7840
YAC - Admirim Dafku	068 253 6720
Ushten - Ismail Jakupi	069 725 0843
RVA - Xhekson Cela	068 547 9457
Qendra Nehemia - Eleonara Xhakollari	069 705 9638
Xhamia Riza Bajram - Kadim Rufati	69 333 2877

Vendakimi i sigurtë në komunitet dhe evakuimi nga komuniteti në rast emergjence.

Disa emergjence mund të kërkojnë evakuim të të gjithë komunitetit të Nishtullës ose të një pjese të tij. Këto evakuime mund të ndodhin para, gjatë ose pas një emergjence.

Agjencitë lokale reaguese të emergjencave kanë përgjegjësinë për caktimin e vendeve të sigurta për evakuim në emergjenca. Megjithatë, nëse do të jetë e nevojshme për një vend të përkohshëm sigurie brenda Nishtullës, mund të shkoni në sheshin pranë Qendrës Shëndetësore 7.2 dhe Qendrës komunitare në Nishtulla. Si vendtakim alternativ do të shërbejë oborri i shkollës “Isuf Ferra”. Për përcaktimin e vendtakimit të sigurt në komunitet dhe të përshtatshmërisë së tij e mira është që të konsultoheni me të gjitha grupet (përfshi gratë).

Në rast evakuimi sipas caktimit të agjencive lokale

- Kërkoni që ti jepet përparësi evakuimeve në zonat dhe për grupet me nivel më të lartë risku.
- Lehtësoni informimin e grupeve më në risk për mundësitë përmes transportit me makina private apo atij të organizuar (bagazhet, pikë nisja, furnizimi me karburant, riparimi emergjent, rrugët e lira, kushtet e strehimit emergjent etj.)
- Informoni grupet që s`pranojnë evakuimin, për rreziqet e qëndrimit në Nishtulla.
- Kërkoni që të evakuuarit vulnerabël të shoqërohen, duke ju ofruar kështu informacion dhe siguri.
- Kërkoni që gjatë evakuimit të ketë informim të vazhdueshëm dhe të ruhet komunikimi.

Veprimet kyç pas një emergjence

- Komunikoni vazhdimisht dhe në forma të ndryshme me komunitetin.
- Nxisni raportimin e dëmtimeve në zyrën e administratës dhe tek kompania siguruese.
- Orientojni individët për procedurat dhe të rejat. Përdorni sqarime të ilustruara për analfabetët;
- Ngrini mekanizma që individët dhe grupet të mund të raportojnë abuzime dhe të parashtrajnë shqetësime.
- Reagoni që të shmangët abuzimi dhe diskriminimi i grupeve të prekura nga emergjenca.
- Krijoni grupe vetë-ndihmëse për emergjencat në komunitet (p.sh. mbledhje donacionesh, dhurim ushqimesh, meremetim dëmsh, pastrim etj.)
- Koordinohuni me mbështetësit e tjerë të sektorëve të ndryshëm.

- Realizoni trajnime për gratë dhe grupet e tjera për t'u rritur kofidencën e pjesëmarrjes.
- Angazhoni personat e trajnuar në takimet dhe planifikimet për emergjencat.
- Planifikoni aktivitete të larmishme, por konsultohuni me grupe të ndryshme (moshore, gjinore, etj.) për të rritur përshtatshmërinë.
- Organizoni aktivitete të larmishme që e ndihmojnë komunitetin që të rrisë reziliencën.
- Mblidhni të dhëna të disagreguara për të gjykuar mbi ndikimin në komunitet dhe ndryshimet e nevojshme.
- Targetoni gjatë monitorimit persona nga grupe të ndryshme që janë prekur nga emergjenca (përfshi dhe vajzat/gratë).
- Përgjigjuni me objektivitet në rast se po pyeteni nga një vlerësues i jashtëm.
- Rikuperoni informacionet dhe të dhënat e rëndësishme.
- Dokumentoni praktikatat e mira.

Rishikimi dhe përmirësimi i Planit Komunitar për Trajtimin e Emergjencave

Planin Komunitar për Trajtimin e Emergjencave, duhet ta rishikoni të paktën një herë në vit sipas një kalendari të përcaktuar. Planin mund ta modifikoni dhe përmirësoni pas ushtrimeve testuese me grupe multidisiplinare dhe pas situatave emergjente reale. Megjithatë, në Planin Komunitar të Trajtitimit të Emergjencave mund të integroni ndryshime edhe pas dinamikave të reja në persona/ numra kontakti, pas marrjes së informacionit për rreziqe apo ndryshime të tjera domethënëse në zonë.

Hartuar nga:

Datë: **10/02/2022**

Klara Margariti - Eksperte IRCA

Me mbështetjen e:

Bledina Bushi - Drejtore QKM

Eleonora Xhakollari - Drejtore Qendra Nehemia

Ili Jakupi - Drejtor Ushten

Altin Xhaferri - Përfqësues i Shoqata Egjyptianët e Bashkuar të Shqipërisë

Lefter Berbiu - Drejtor Shkolla Isuf Ferra

Qani Xhixha - I plotfuqishëm i zonës

Xhemil Ribaj - Inspektor pranë zjarrfikëses

Evis Como - Mjeke Qendra Shëndetësore 7.2

Aneks 1. Plani familjar i sigurisë për emergjencat

Përgatituni për emergjencat. Bëhuni gati, mësoni anëtarët e familjes tuaj të dinë ç'të bëjnë që të jeni të përgatitur për emergjencat që mund t'ju godasin.

Nr.	Kryefamiljari	Adresa e banesës	Nr. i telefonit	Data e përditësimit
1		_____		___/___/2022

Listoni anëtarët e tjerë të familjes

Nr.	Emri Mbiemri	Mosha	Gjendja shëndetësore	Nr. i telefonit
1			_____	
2			_____	
3			_____	
4			_____	
5			_____	

Zgjidhni mikun ose një të afërmin që jeton pranë jush të cilin do e njoftoni për ti thënë se jeni mirë apo keni nevojë për ndihmë

Nr.	Emri Mbiemri	Marrëdhënia	Adresa	Nr. i telefonit
1			_____	
2			_____	

Zgjidhni persona kontakti që jetojnë jashtë zonës së Nishtullës

Nr.	Emri Mbiemri	Marrëdhënia	Adresa	Nr. i telefonit
1			_____	
2			_____	

Listoni numra kontakti të tjerë

Nr.	Emërtimi	Nr. i telefonit	Nr.	Emërtimi	Nr. i telefonit
1	Policia	129	12	Dentist	
2	Policia Rrugore	126	13	Veteriner	
3	Emergjenca	112	14	Agjenci Sigurimi Shëndetsor	
4	Karroatrec		15	Edukatorja e kopshtit të fëmijëve	
5	Mekanik		16	Edukatorja e çerdhës	
6	UKD	052 902 222	17	Mësuesi kujdestar i shkollës	
7	Farmacist		18	Punëdhënësi nëna	
8	Zjarrfikës	128	19	Punëdhënësi babai	
9	Urgjencë	127	20	Banka	
10	Mjek i familjes		21	Televizioni	
11	Pediatër		22	Tjetër _____	

Shënoni dhe cilësoni emergjencat që kanë më shumë gjasa që mund t'ju prekin si familje

- tërmet
- cunami
- rrëshqitje
- shembje objekti
- stuhi
- përmbytje
- thatësi
- reshje të mëdha
- aksident (rrugor, ajror, detar, hekurudhor etj).
- mbetje të rrezikshme
- zjarr
- depo ushtarake
- shpërthim gazi/karburanti, etj.
- grabitje
- dhunë
- sëmundje/epidemi
- turmë njerëzish
- veprimtari terroriste
- nisje lufte
- Tjetër _____
- Tjetër _____
- Tjetër _____
- Tjetër _____

Shënoni me kryq dhe cilësoni çfarë përmban çanta/kutia e emergjencës:

- Ujë dhe ushqim
- Medikamente dhe dokumente kyç mjekësore
- Dokumente të rëndësishëm
- Karikues telefoni/bateri rezerve
- Syze
- Lines/pampers
- Facoleta/letër higjienike
- Hartë
- Bilbil
- Elektrik dore/koke +bateri
- Qirinj, elektrik me bateri
- Çakmak
- Kaçavidë/pincë/thikë
- Veshje/batanije
- Lekë të thata
- Llogari/kod bankare
- Llogari (pasworde e-Albania/e-mail etj.)
- Letër/laps
- Qeska
- Broshurë për ndihmën e parë dhe mbijetesën
- Informacion si mund të fiken pajisjet
- Fotografi/video të shtëpisë bazës materiale
- Celësa rezervë të dyerve
- Tjetër _____

Saktësoni që vendi ku ndodhen çanta/kutia e emergjencës në:

shtëpi _____ punë _____

makinë _____ tjetër _____

Saktësoni mënyra të tjera të largimit nga banesa

- dritarja
- shkallet
- dera e emergjencës _____
- avllia _____
- makina _____
- tjetër _____

Saktësoni hapat që do ndiqen në një emergjencë nga familja juaj

Saktësoni rolet dhe përgjegjësitë e secilit në familje

Nr.	Emri Mbiemri	Përgjegjësitë (p.sh. koordinon, shofer, përkujdeset, telefonon, etj.)
1		_____
2		_____
3		_____
4		_____

Saktësoni vendtakimin e sigurt në emergjencë për familjen

Dhoma/vendimëisigurtishtëpisë _____

Vendtakimi afër shtëpisë tuaj nëse ndaheni në rast emergjence

Vendtakimi 1 _____

Vendtakimi 2 _____

Vendtakimi në lagje nëse nuk mund të ktheheni në shtëpi ose ju kërkohet të evakuoheni

Vendtakimi 1 _____ Itenerari _____

Vendtakimi 2 _____ Itenerari _____

Saktësoni çfarë do të ndryshoni/përmirësoni për të reduktuar rrezikun (psh pako të ndihmës së shpejtë, dera e dytë rezervë, dalja dytësore, shkallët e emergjencës, banesë më e qëndrueshme, makinë e mirëmbajtur) Kur?

Nëse është e sigurt, kontrolloni fqinjët dhe njerëzit e pambrojtur që jetojnë pranë jush

Emri:.....

Emri:.....

Adresa:.....

Adresa:.....

.....

.....

.....

.....

Tel Numri:.....

Tel Numri:.....

Urime! Ju e plotësuat planin tuaj të emergjencës si familje. Iu thoni edhe të afërme dhe miqve tuaj që të bëjnë një të tillë.

Aneks 2. Fletë volant

Komuniteti ynë i Nishtullës ka një Plan për Emergjencat që synon të ulë rrezikun prej incidenteve dhe emergjencave përmes udhëzimit dhe angazhimit të shpejtë dhe efikas të komunitetit.

Ju lutemi që në situatë emergjence të menjëhershme të telefononi:

- **112** nëse nuk dini si ti kontaktoni shërbimet përkatëse të emergjencës.
- **126** nëse ju duhet ndihmë nga policia rrugore
- **127** nëse dikujt i nevojitet kujdes i shpejtë mjekësor, dikush është i plagosur rëndë ose nëse jeni dëshmitar i një ngjarjeje që po ndodh (sulm, vrasje, grabitje, thyerje, aksident etj.).
- **128** nëse ju duhet ndihmë nga shërbimi zjarrfikës.
- **129** nëse rrezikoni jetën ose nëse i dyshuari është afër.

Të gjithë këta numra janë falas dhe mund të thirren nga çdo telefon.

Nëse situata nuk përbën emergjencë të menjëhershme mund të telefononi **Specialistin e Policisë së Zonës z. Qani Xhixha në numrin 069 61 51 142.**

Kur telefononi shërbimet e emergjence i thoni Operatorit:

- Kush jeni? Cilin shërbim kërkon?
- Çfarë ka ndodhur? Sa janë të sëmurë, të dëmtuar, të rrezikuar apo viktime dhe nga se? Si është gjendja?
- Çfarë ndihme nevojitet? Ku duhet të vijë ndihma? Cila rrugë është më e gjerë/lartë dhe lejon kalimin e automjeteve të emergjencës?

Kujdes! Mos e mbyllni telefonin pa marrë konfirmimin e marrjes së të dhënave nga Operatori i urgjencës.

Nëse emergjenca shtrihet në mbarë komunitetin e Nishtullës ju mund të kontaktoni Grupin tonë Komunitar të Emergjencave

(Emër mbiemër) _____ Koordinator (Numër kontakti) _____

(Emër mbiemër) _____ Anëtar zona 1 (Numër kontakti) _____

(Emër mbiemër) _____ Anëtar zona 2 (Numër kontakti) _____

(Emër mbiemër) _____ Anëtar zona 3 (Numër kontakti) _____

(Emër mbiemër) _____ Anëtar zona 4 (Numër kontakti) _____

Vendtakim ynë i sigurt brenda Nishtullës është sheshi pranë Qendrës Shëndetësore 7.2 dhe Qendrës Komunitare Multifunkionale në Nishtulla.

Aneks:3. Mbledhja e parë e Grupit Komunitar të Emergjencave në Nishtulla

Data: ___/___/___ Ora: _____ Vendi: _____

Të pranishmit: _____

1. Cila është situata aktuale?

Çfarë informacioni ka, nga kush vjen dhe a është i saktë?

Ku është vendndodhja e emergjencës?

Cili është lloji i emergjencës?

Sa dhe si e kërcënon jetën?

A është dëmtuar energjia elektrike, gazi apo uji?

Cilët njerëz vulnerabël preku?

Çfarë burimesh na duhen?

Si mund të ndihmojë komuniteti?

2. Si do të vendoset kontakti me reaguesit e emergjencës?

3. Si mund t'i mbështeten reaguesit e emergjencës?

4. Çfarë veprimesh të sigurta mund të ndërmerren?

5. Kush do të marrë drejtimin për veprimet e dakordësuara?

6. Si do të qëndrohet në kontakt?

7. Çfarë nevojitet dhe kur nevojitet për të mbështetur përpjekjet tona?

(Për shembull, disa lajmëtarë tani për të përhapur një mesazh evakuimi, shumë vullnetarë më vonë kur njerëzit janë gati për t'u zhvendosur)

8. Ndonjë çështje tjetër?

Materiale informuese dhe referenca

Argyll and Bute Council, How to make a community emergency plan tërhequr nga <https://www.argyll-bute.gov.uk/how-make-community-emergency-plan>

BASHKIA LEZHË (Dhjetor 2020) Plani i Emergjencave Civile

Cooperative governance and traditional affairs, republic of south Africa (2014) Disaster management monitoring and evaluation framework tërhequr nga <http://www.ndmc.gov.za/Frameworks/Disaster%20Management%20Monitoring%20and%20Evaluation%20Framework.pdf>

DISASTER PREPAREDNESS PLAN Template for use in LONG TERM CARE FACILITIES tërhequr nga <https://snohomishcountywa.gov/DocumentCenter/View/6218/Long-Term-Care-Facility-Template?bidId=FAO> (2018) Analizë gjithëpërfshirëse e reduktimit të rrezikut nga fatkeqësitë dhe e sistemit të menaxhimit për bujqësinë në Shqipëri tërhequr nga: <https://www.fao.org/3/i8866SQ/i8866sq.pdf>

FCC and FEMA (21 september 2011) How to Communicate Before, During and After a Major Disaster tërhequr nga <https://www.fcc.gov/news-events/blog/2011/09/21/fcc-and-fema-how-communicate-during-and-after-major-disaster>

Fema and American Red cross (2004) Food and Water in an Emergency tërhequr nga <https://www.fema.gov/pdf/library/f&web.pdf>

Pan American Health Organization Humanitarian supply management in logistics in the health sector Washington, D.C. (2001) Humanitarian Supply Management and Logistics in the Health Sector tërhequr nga <https://www.paho.org/disasters/dmdocuments/humanitarianSupplyBook.pdf>

PointClickCare, THINKANEW Disaster Preparedness Plan tërhequr nga https://pages.pointclickcare.com/rs/740-IBO-752/images/Disaster%20Recovery%20Preparedness%20Plan.pdf?mkt_tok=3RkMMJWWfF9wsRoiv6vMZ-KXonjHpfsX76%2BovW6SwIMl%2F0ER3fOvrPUfGjI4JSMNjl%2BSLDwEYG-Jlv6SgFTbTFMali1bgKXhM%3D

Rudina Toto, Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit (2020) Dokument politikash mundwsiimi I aftwsiwe ripwrtwritwse sw qeverive vendore nw Shqipwri: sfidat ligjore dhe institucionale tërhequr nga <https://www.co-plan.org/wp-content/uploads/2020/05/Resilience-Bashkite-Shqiperi.pdf>

Sedgwick Parish Council (May 2021) Sedgwick Parish Community Emergency-restricted version tërhequr nga https://www.sedgwickparishcouncil.org.uk/uploads/1/1/7/5/117598396/sedgwick_parish_emergency_plan_may_2021__unrestricted_version.pdf

Shoqata e Bashkive të Shqipërisë dhe me mbështetjen e Fondacionit Hanns-Seidel, Shqipëri, (2018), Udhëzues për bashkitë për menaxhimin e emergjencave civile” tërhequr nga <https://aam.org.al/wp-content/uploads/2019/11/Guida-e-emergjencave-faqosur.pdf>

TDM Encyclopedia (23 March 2016) Emergency Response Transport Management Managing Transportation Systems During Disasters tërhequr nga <https://www.vtpi.org/tdm/tdm124.html>

UNDP (2003) Vlerwsi i rreziqeve nga fatkeqwsitw nw Shqipwri tërhequr nga: <https://www.geo.edu.al/durres/risk.pdf>

Universiteti POLIS, Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit I A.U.A - Unioni Shqiptar i Arkitektëve, Urbanistëve dhe Planifikuesve (2019) Dokument Pozicionimi: Rindërtimi i Qytetit Pas Krizës -Vetëripërtëritja (Resilenca) Urbane Pas Tërmetit

World Health Organization Geneva (1999) Community emergency preparedness: A manual for managers and policy-makers tërhequr nga <http://apps.who.int/iris/bitstream/handle/10665/42083/9241545194.pdf;jsessionid=1605C0A-C4AEBC8CF8E3ED1364CE6C497?sequence=1>

World Vision (2020) Kwshilla pwr zvogwlimin e rreziqeve nga katastrofat dhe fatkeqwsitw tërhequr nga https://www.worldvision.al/keshilla-zvogelimin-e-rreziqeve-nga-katastrofat-fatkeqesite?fbclid=IwAR0HtdiRBwJnpU_VKwg-DRO4NeRawWU58fSyaXI47M7mDD-nHu-a-tbLOVZE

Republika e Shqipërisë, “Ligji nr. 15/2016 “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”

Republika e Shqipërisë, Akti Normativ Nr. 9 datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”

Republika e Shqipërisë, Ligji nr. 10465, datë 29.09.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”

Republika e Shqipërisë, Ligji nr. 111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”

Republika e Shqipërisë, Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”

Republika e Shqipërisë, Ligji nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”

Republika e Shqipërisë, ligji 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”

Republika e Shqipërisë, Ligji nr. 8518, datë 30.7.1999 “Për ujitjen dhe kullimin”

Republika e Shqipërisë, Ligji nr. 8756, datë 26.3.2001 “Për emergjencat civile” i përditësuar në 2009.

Republika e Shqipërisë, Ligji nr. 9244, datë 17.6.2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”.

Republika e Shqipërisë, Ligji nr. 152/2015, datë 21.12.2015, “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”

Udhëzimi i Ministrisë së Punëve të Brendshme nr. 3, datë 4.3.2003 “Për kriteret e përzgjedhjes së personelit të strukturave të emergjencave civile”.

VKM nr. 148, datë 24.02.2016 “Për ngritjen dhe funksionimin e sistemit të integruar të informacionit dhe statistikës të Këshillit të Ministrave”.

VKM nr. 329, datë 16.5.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”.

VKM nr. 531, datë 1.8.2003 “Për organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e Shërbimit të Emergjencave Civile”

VKM nr. 532, datë 1.8.2003 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e Departamentit të Planifikimit dhe të Përballimit të Emergjencave Civile”

VKM nr. 533, datë 1.8.2003 “Për pjesëmarrjen e shtetasve në parandalimin dhe përballimin e emergjencave civile”

VKM nr. 654, datë 18.12.2002 “Për përcaktimin e tarifave për përdorim të përkohshëm nga organet shtetërore, në situata emergjente, të çdo mjeti privat”.

VKM nr. 655, datë 18.12.2002 “Për ngritjen dhe funksionimin e strukturës së sistemit kombëtar të planifikimit dhe të përballimit të emergjencave civile”

VKM nr. 663, datë 18.12.2002 “Për përbërjen, funksionimin dhe përgjegjësitë e Komisionit Teknik Këshillimor të specialistëve për emergjencat civile”.

VKM nr. 664, datë 18.2.2002 “Për kriteret dhe procedurat e shpalljes së gjendjes së emergjencës civile”

VKM Nr. 753, datë 30.11.2019 “Për Përkrahjen Sociale dhe Financiare të Familjeve të Viktimave të Tërmetit.

VKM nr. 965, datë 2.12.2015 “Për bashkëpunimin ndërinstitucional të strukturave të drejtimit, në rastet e emergjencave civile dhe krizave”.

VKM Nr.243, datë 24.3.2020 “Për shpalljen e gjendjes se fatkeqësisë natyrore”

VKM Nr.750, Datë 27.11.2019 “Për Shpalljen e Gjendjes së Fatkeqësisë Natyrore në Qarqet Durrës dhe Tiranë”

VKM nr. 1020, datë 16.12.2020 “Për përbërjen, funksionimin dhe detyrat e Komisionit Teknik Këshillimor për zvogëlimin e riskut ndaj fatkeqësive”

VKM nr. 923, datë 25.11.2020 “Për funksionimin e organizimin e Komitetit të Mbrojtjes Civile dhe bashkëpunimin ndërinstitucional të institucioneve dhe të strukturave të sistemit të mbrojtjes civile”

VKM nr.747, datë 20.11.2019, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile”.

